

FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS
KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORE PËR PËRZGJEDHJE TË PËRZGJEDHËSIT TË
PËRFAQËSUESËS SË KOSOVËS

Prishtinë, 2021

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore do të përcaktojë dhe rregullojë mënyrën e përzgjedhjes së Përzgjedhësit të Përfaqësueses së Kosovës.

Neni 2

Përzgjedhësi/t do të zgjedhen nga Bordi Ekzekutiv i Federatës së Karatesë së Kosovës, pas pranimit të aplikacioneve dhe përfundimit të procedurave shqyrtuese.

Neni 3

Secili person i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë rregullore mund të zgjedhet Përzgjedhës i Përfaqësueses së Kosovës në Karate.

Neni 4

Kushtet që duhet plotësuar për zgjedhjen e Përzgjedhësit:

1. Të ketë së paku nivelin më të ultë të mundshëm profesional të arsimit të mesëm.
2. Diploma/Certifikata mbi Përgatitjen e tij/saj profesionale (DAN)
3. S'paku pesë (5) vite përvojë pune të pandërprerë në sportin e karatesë,
4. Rezultate të theksuara në punën profesionale dhe pedagogjike me ekipe në sportin e karatesë,
5. Rezultate të theksuara në garat zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare,
6. Preferohet njohja e njërës nga gjuhët zyrtare të WKF-it (angleze, spanjolle dhe frenge).

Neni 5

Përzgjedhësi është i pavarur në punën e tij. Për punën e tij Përzgjedhësi i përgjigjet Bordit të FKK-së.

II. MANDATI

Neni 6

Përzgjedhësi zgjedhet me mandat 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

III. SHKARKIMI I PËRZGJEDHËSIT

Neni 7

Përzgjedhësi mund të dorëhiqet me vetëdëshirë. Shkarkimi, suspendimi mund të bëhet sipas Rregullores Disiplinore dhe për shkelje tjera të Statutit, rregulloreve të FKK-së

dhe shkelje të kësaj rregulloreje, si dhe për çfarëdo shkelje të etikës dhe prestigjit të karatesë apo Kosovës gjatë përfaqësimit në gara.

Në rastë të performancës së dobët dhe dështimit të përmbushjes së planit të propozuar nga vet ai/ajo në periudhën kohore prej dymbdhjetë (12) muajësh mund t'i kërkohet dorëheqja ose Bordi mund të marr iniciativë për shkarkimin e tij/saj.

IV. AFATI I PARAQITJES SË APLIKACIONEVE PËR PËRZGJEDHËS

Neni 8

Afati i aplikimit është 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit. Afati i zgjedhjes është deri në 30 ditë nga data e përfundimit të pranimit të aplikacioneve. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merrn në shqyrtim sipas nenit 9. Afati i ankimimit është 7 ditë kalendarike.

Neni 9

Aplikacioni i kompletuar duhet të përmbajë:

- a) Diplomën arsimore
- b) CV-in
- c) Diplomat/cetifikatat relevante (DAN)
- d) Certifikata për trajner vendor/ndërkombtar
- e) Dëshmi për punën aktive në 5 vitet e fundit
- f) Dëshmi për rezultate e arritura
- g) Planin fillestar të punës me trajner dhe garues
- h) Planin katër vjeçar të punës si përzgjedhës


V. HYRJA NË FUQI

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Kryetari i FKK-së



Ismet Krasniqi